



Këshilla të urta

nga

Sejjid Ali Khamenei

Përzgjedhi dhe përktheu:

Vullnet Merja

Tiranë, 2014

Titulli: Këshilla të urta nga Sejjid Ali Khamenei

Përzgjodhi dhe përktheu: Vullnet MERJA

Redaktoi: Liseda RAMAJ

Korrekttoi: Vjollca KARAJ

Përgatitja për shtyp dhe kapaku: Sabrie FEZA

Botoi: Shoqata "FLLADI"

Biografia e Sejjid Ali Khamenei

Fëmijëria

Ajetullah haxhi sejjid Ali Khamenei është i biri i të ndjerit ajetullah sejjid Xhevad Husein Khamenei. Ai lindi në Meshhed, më 17 Qershor 1939 (1358 hixhri). Ai ishte djali i dytë i familjes. Jetoj një jetë të thjeshtë, si shumë dijetarë të asaj kohe.

Në kujtimet e jetës së tij në familjen e babait, ajetullah Khamenei thotë: *“Babai im ishte një dijetar i njohur feje shumë i devotshëm. Ne kishim një jetë të vështirë. Më kujtohet se ndonjëherë nuk kishim asgjë për të ngrënë në shtëpi gjatë darkës. Ai sërish mendohej të gjente diçka për darkë, qoftë edhe bukë me rrush të thatë.*

Shtëpia e babit tim, aty ku linda dhe jetova deri në moshën katër ose pesë vjeçare, ishte në një zonë shumë të varfër të Meshhedit. Shtëpia kishte vetëm një dhomë dhe një bodrum të zymtë. Sa herë që një mik vinte të shikonte babain, ne duhej që të qëndronim në bodrum, deri sa ai të ikte. Ideja e babait ishte që shtëpia e një dijetari të fesë ishte vendi ku njerëzit do të vinin të kërkonin ndihmë. Disa vite më vonë, një grup njerëzish, të cilët ishin shumë të dashur për babain tim, blenë një vend të vogël

pranë shtëpisë sonë, kështu ne përfunduam në një shtëpi me tre dhoma."

Lideri i Revolucionit Islamik u rrit i varfër, por me besim, babai i të cilit ishte një dijetar fetar i devotshëm dhe i singertë.

Ajetullah Khamenei studioi shumë libra, si "Xhameatul-Mukaddimat", "Mughni" dhe veprat e Sujutit në shkollat fetare "Sulejman Khan" dhe "Nevvab" në saje të mbikëqyrjes së babait të tij. Ai, gjithashtu, studioi librat e Mu`alim, ndërkohë që ndiqte këto shkolla. Më pas, ai studioi "Sherai` al-Islam" dhe "Sherh Lum`ah" me babain e tij dhe një pjesë të librit të dytë të të ndjerit haxh sheikh Hashim Kazvini. Në pjesën e mbetur, studioi jurisprudencë dhe principet e saj (fikh dhe usul) me babain e tij. Në këtë mënyrë, ai përfundoi nivelin mesatar të studimeve me rezultate të larta. Gjithashtu, babai i tij, i ndjeri sejjid Xhevad luajti një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e djalit të tij.

Në fushën e logjikës dhe të filozofisë, lideri i madh i Revolucionit Islamik, ajetullah Khamenei, i nisi studimet e tij me ajetullah Mirza Xhevad Akah Tehrani. Më pas i vazhdoi me Manzumah e Sebzevari dhe i mbaroi ato me të ndjerin sheikh Ridha Ajsi. Në moshën tetëmbëdhjetë vjeçare, ajetullah Khamenei filloi studimet e larta të jurisprudencës dhe principet e saj me të ndjerin ajetullah al-udhma Milani në Meshhed. Në vitin 1957, me qëllimin për të vizituar vendet e shenjta, ai u nis për në Nexhef. Pasi vrojtoi situatën në Nexhef dhe ndoqi mësimet në shkollën

e lartë, ai vendosi të qëndronte në seminarin islamik të Nexhefit. Megjithatë, babai i tij nuk e pranoi vendimin e tij, kështu që ai u kthye në Iran pas një periudhe të shkurtër. Mësimet në shkollën e lartë i ndoqi nga: sejjid Muhsin Hakim, sejjid Mahmud Shahrudi, Mirza Bakir Zanzhani, sejjid Jahja Jezdi dhe Mirza Hasan Buxhnurdi.

Nga viti 1958 deri më 1964, ajetullah Khamenei vazhdoi studimet e larta në jurisprudencë dhe filozofi në një seminar islamik në Kum. Atje ai ndoqi hapat e mësuesve të mëdhenj, si i ndjeri ajetullah al-udhma Buruxherdi, imam Khomeini, sheikh Murtaza Hai'ri Jezdi dhe Al'lame Tabataba'i. Në vitin 1964 pas një sërë letrash nga babai i tij, lideri suprem i Revolucionit Islamik, mësoi se babai i tij u verbua nga njëri sy si pasojë e kataraktit. Kjo e vendosi atë në një dilemë: të qëndronte në Kum dhe të vazhdonte studimet apo të kthehej në Meshhed dhe të kujdesej për babain e tij. Ai, më pas, mori një vendim për hir të Allahut, që të kthehej në Meshhed dhe të kujdesej për babain e tij. Në kujtim të kësaj ngjarjeje, ai thotë: *“Pasi u ktheva në Meshhed, Allahu më bekoi që unë të kujdesesha për punët e mia. Kam qenë i suksesshëm në jetë. Unë besoj se të gjitha këto rrjedhin nga veprimet e mira që kam bërë për prindërit e mi, veçanërisht për babain.”* Ajetullah Khamenei bëri zgjedhjen më të mirë, edhe pse disa nga mësuesit dhe shokët shprehën keqardhje për largimin e tij nga Seminari Islamik i Kumit. Ata parashikuan se nëse ai do të qëndronte, e priste një e ardhme e suksesshme. Megjithatë, e ardhmja iu shfaq në mënyrë të qartë, kur ai bëri

zgjedhjen e duhur, pasi fati i tij kishte rezervuar diçka më të mirë për të. A mund ta imagjinonte ndonjëri se ky studiues i ri në moshën 25 vjeçare do të linte Kumin për kënaqësinë e Allahut, për t'u kujdesur për prindërit e tij? 25 vjet më vonë do të vendosej në zyrën e madhe të Udhëheqësisë Myslimane.

Në Meshhed ai nuk i la studimet. Ai vazhdoi studimet për jurisprudencë dhe për parimet sipas mësuesve të tij, si ajetullah Milani, deri më 1968. Ndërprerjen e mësimeve e bënte vetëm në kohën e pushimeve, për t'u marrë me aktivitete politike. Që nga koha e kthimit në Meshhed, në vitin 1964, ndërkohë që kujdesej për prindërit e tij, ai duhet të mësonte jurisprudencën dhe parimet e saj, si dhe subjekte të tjera fetare për studentët e rinj të seminarit dhe të universitetit.

Fushata politike

Ajetullah Khamenei është një nga studentët e imam Khomeinit në fushën e jurisprudencës, të parimeve të tij dhe në idetë revolucionare dhe politike. Gjithësesi, shkëndija e parë e aktivizimit të tij politik dhe urrejtja për shtypjen u frymëzuan nga revolucioni i madh i dëshmorit sejjid Muxhtaba Nevab Sefavi. Ishte viti 1952 kur Nevab Sefavi dhe disa mbështetës shkuan në Meshhed tek shkolla "Sulejman Khan". Atje ai mbajti një leksion dinamik për

rigjallërimin e Islamit, për rregullat e shenjta dhe e paralajmëroi popullin iranian për gënjeshtat mashtruese të Shahut dhe të qeverisjes angleze. Në atë kohë, ajetullah Khamenei ishte një nga studentët e rinj të shkollës “Sulejman Khan”, i cili mori pjesë në fjalimin e zjarrtë të Nevab Sefavi. Ai ishte shumë i ndikuar nga një revolucionalist i madh. Ajetullah Khamenei ka thënë: *“Nuk ka dyshim se Nevab Sefavi ishte i pari që ndezi zjarrin (e Revolucionit Islamik) në zemrën time.”*

Në vitin 1962, ndërkohë që ajetullah Khamenei ishte akoma në Kum, ai u bashkua me Lëvizjen Revolucionare të imam Khomeinit, duke iu kundërvënë proamerikanëve dhe duke qëndruar kundër politikave islame të mbretit Muhamed Riza. Krahas gjithë rënieve dhe ngritjeve, persekutimeve, dëbimeve dhe burgimit, ajetullah Khamenei e vazhdoi i patrembur rrugën e tij për gjastëmbëdhjetë vjet.

Në muajin Muharrem të vitit 1383 Hixhri Kameri (maj 1963), ajetullah Khamenei u dërgua nga imam Khomeini në një mision. Ky mision kishte si qëllim komunikimin e mesazhit të Imamit tek ajetullah Milani dhe klerikët e tjerë në Horasan. Ky mesazh kishte si qëllim vendosjen e theksit të përhapja dhe ekspozimi i politikave proamerikane të Muhamed Riza Shah në muajin Muharrem.

Khamenei e përmbushi misionin e tij dhe gjithashtu veproi mbi kërkesat e tij, meqë ai ishte dërguar për

propagandë në muajin Muharrem. Si rezultat, nga propaganda e tij, në ditën e nëntë të muajit Muharrem (2 Qershor 1963) ai u arrestua. Ai u burgos dhe u lirua me kushtin që të mos kthehej asnjëherë në minber që të fliste sërish. Nga ai moment, ai kuptoi që do të ishte nën vëzhgimin e policisë. Me zhvillimin e ngjarjes së përgjakshme së “Pesëmbëdhjetë Qershorit”, ajetullah Khamenei u dërgua në paraburgim në Bixhend dhe u transferua në burgun e Meshhedit, ku qëndroi dhjetë ditë dhe u torturua përpara se të lirohej.

Në janar të vitit 1964 (Ramazan 1383), sipas një plani të mirorganizuar, ajetullah Khamenei dhe disa nga shokët e tij u larguan për në Kerman. Pas dy-tre ditësh predikimi dhe vizitash me dijetarë fetarë dhe studentë në Kerman, ata u nisën për në Zahedan. Predikimi dhe këmbëngulja e tyre për ekspozimin e referendumit hipokrit të Shahut ishte i mirëpritur nga masa, veçanërisht më 6 Janar, në kohën e zgjedhjeve. Në ditën e 15 të Ramazanit, në ditëlindjen e Imam Hasanit (*paqja qoftë mbi të!*), predikimi i tij i zellshëm dhe bërja publike e politikave satanike të Amerikës, të dinastisë së Pehlavit arriti kulmin. Si rezultat i kësaj, Savaku (agjencia e zbulimit të Shahut) e arrestoi atë natën. Atë natë ata e morën atë me aeroplan për në Teheran. Lideri i madh kaloi pothuajse dy muaj në izolim duke duruar tortura të ndryshme.

Leksioni që ai mbajti në lidhje me Kur’anin, profetësinë dhe ideologjinë islame në Meshhed dhe në Teheran u mirëprit ngrohtësisht nga revolucionarët. Për

shkak të kësaj, Savaku nisi të mbante një lidhje të ngushtë me ajetullah Khamenein. Në vitin 1967, ajetullah Khamenei u detyrua me forcë të jetonte në bodrum. Një vit më vonë, ai u kap dhe u burgos nga Savaku. Ai u arrestua sërish nga Savaku për të njëjtat arsye, për mbajtjen e klasave, kryerjen e shkollimeve dhe diskutimeve intelektuale.

Ajetullah Khamenei shkruan për kapjen e tij të pesëmbëdhjetë nga Savaku, duke thënë: *“Nga viti 1348 [1970] situata për revolucionin e armatosur në Iran ishte e tensionuar. Ndjeshmëria dhe ashpërsia e regjimit kundër meje ishte rritur. Për shkak të rrethanave, ata nuk ishin në gjendje t’i refuzonin njerëzit si unë. Në 1350 [1972] u futa në burg për të pesëmbëdhjetën herë. Qëndrimi i ashpër i Savakut tregoi se sistemi (regjimi) ishte shumë i frikësuar.*

Ata do të besonin se aktivizimi im intelektual dhe propaganda në Meshhed nuk kishte të bënte aspak me zhvillimin e situatës. Pasi u lirova, pjesëmarrja në klasat e hapura të shpjegimit të Kur’anit, të mësimëve private të ideologjisë dhe të subjektet e tjera të përfshira ishin rritur.”

Në vitet 1972 dhe 1975 mësimet e ajetullah Khameneit mbi Kur’anin dhe mbi ideologjinë islame mbaheshin, tashmë, në tre vende: në xhamitë “Keramat”, “Imam Hasan” dhe “Mirza Xhafer”, për tërë qytetin e Meshhedit. Mijëra njerëz iu bashkuan mësimëve të tij, veçanërisht rinia dhe studentët aktivë. Leksionet e tij u transkriptuan dhe u publikuan. Revolucionistët e rinj, që ishin mësuar me realitetin dhe kuptimin e së vërtetës nëpërmjet luftës së ajetullah Khameneit, ishin shumë të

zellshëm në shpërndarjen e kësaj ideologjie tek masa në qytetet më të afërta. Ky veprim bëri që Savaku të hynte brenda shtëpisë së tij në Meshhed në dimrin e vitit 1975, duke e arrestuar atë dhe konfiskoi shumë shënime të tij dhe të dijetarëve të tjerë. Ky ishte arrestimi i gjashtëmbëdhjetë dhe më i vështiri në jetën e ajetullah Khameneit. Ai u burgos në burgun qendror të Iranit, deri në 1976 në kushte shumë të rrepta. Ajetullah Khamenei i përkruan ato kushte tepër të ashpra. Pasi u lirua nga burgu, ajetullah Khamenei u kthye sërish në Meshhed, ku vazhdoi politikën e tij dhe aktivitetet e revolucionit, edhe pse nuk ishte në gjendje t'i rivendoste klasat e mëparshme.

Ajetullah Khamenei u kap dhe u internua nga regjimi i paligjshëm i Pehlavit në fund të vitit 1976, në Iranshahr për një periudhë trevjeçare. Në mesin e vitit 1979, gjatë kulmit të trazirave civile në Iran, ai u rikthye në Meshhed, ku u përball me regjimin e përgjakshëm të Pehlavit. Pesëmbëdhjetë vjet më vonë, pasi duroi të gjithë ashpërsinë dhe momentet e hidhura të Revolucionit Islamik, ajetullah Khamenei ishte dëshmitar i rënies së regjimit tiranik të Pehlavit dhe i themelimit të Republikës Islamike.

Në prag të fitores së Revolucionit Islamik, përpara se imam Khomeini të kthehej në Iran nga Parisi, Këshilli i Revolucionit Islamik ishte themeluar nga Imami. Ky këshill ishte i përbërë nga personalite të rëndësishme, si Murteza Muttaheri (dëshmor), Beheshti (dëshmor) dhe Hashemi Refsanxhani. Ajetullah Khamenei, me dekret të

imam Khomeinit, u bë pjesëtar i këtij këshilli. Pas kësaj, pas marrjes së këtij mesazhi përmes Muttaharit, ajetullah Khamenei u largua nga Meshhedi për në Teheran.

Pas fitores së Revolucionit Islamik, ajetullah Khamenei vazhdoi të ishte shumë aktiv në punën e tij për Islamin dhe për përmbushjen e objektivave të Revolucionit Islamik.

Në shkurt të vitit 1979 një nga themeluesit e Republikës Islamike, u bashkua me të gjitha partitë në vend dhe ranë në një mendim me dijetarët: Beheshti, Bahunar, Musavi Ardebili dhe Hashemi Refsanxhani. Sipas një rendi kohor, detyrat e ajetullah Khameneit në Republikën Islamike të Iranit dhe pas fitores së Revolucionit kanë qenë:

1980 – Sekretar i Mbrojtjes

1980 – Mbikëqyrës i Gardës Revolucionare Islamike

1980 – Udhëheqës i namazit të xhumasë me xhemat

1980 - Përfaqësues i Teheranit në Asamblenë Konsultative

1981 – Përfaqësues i Imam Khomeinit në Këshillin e Lartë të Sigurisë

1981 – Përfaqësues aktiv në frontin e luftës së imponuar mes Iranit dhe Irakut

1982 - President i Republikës Islamike të Iranit, pas martirizimit të dëshmorit Muhamed Ali Raxhai. Ky ishte mandati i tij i parë në detyrë. Kreu dy mandate në detyrë, që zgjatën deri në vitin 1990.

1982 - Kryetar i Këshillit të Lartë të Revolucionit në Punët e Kulturës

1988 - President i Këshillit të Oportunitetit

1990 - Kryetar i Kushtetutës i Komitetit të Rishqyrtimit

1990 - Udhëheqës Suprem i Republikës Islamike të Iranit nga zgjedhja e Këshillit të Ekspertëve

Puna e shkruar

Shkrimet dhe puna e tij kërkimore

- 1- Një pasqyrë e plotë e mendimit islam në Kur'an
- 2- Mençuria e lutjes
- 3- Një ligjëratë për durimin
- 4- Libri Major Katër Lidhur me biografik e tradicionaliste
- 5- Vilajeti - Kujdestaria
- 6- Një paraqitje e shkurtër në historinë dhe gjendjen e mëparshme të Seminarit Islamik në Meshhed
- 7- Biografia e imamëve shiitë (*paqja qoftë mbi ta*)
- 8- Imam Sadiku (*paqja qoftë mbi të*)
- 9- Uniteti dhe partitë politike
- 10- Art në këndvështrimin e Ajetullah Khameneit
- 11- Kuptimi i saktë i Islamit
- 12- Ligjërata e Vilajetit

Përkthime (nga arabishtja në persisht)

- 1- Traktati i paqes i imam Hasanit (*paqja qoftë mbi të*)
- 2- E ardhmja nga një perspektivë islame
- 3- Myslimanët në çlirimin e Indisë
- 4- Peticion kundër qytetërimit perëndimor

Udhëheqja

Duke vuajtur nga një sëmundje e gjatë, themeluesi i Republikës Islamike të Iranit, i cili ringjalli Islamit në botën materialiste dhe të zezë të shekullit të tetëmbëdhjetë, i ndjeri imam Khomeini, shkoi pranë Allahut me zemër të sigurtë dhe mendje të qetë. Njerëzit përjetuan një dhimbje dhe hidhërim të thellë, sa nuk mund ta besonin çfarë kishte ndodhur.

Imam Khomeini kishte përcaktuar në testamentin e tij politikën e tij, të cilën, djali i tij, haxhi Ahmed (dëshmor) ose presidenti, duhet ta rrëfente. Pas refuzimit të haxhi Ahmedit, lartësia e tij, ajetullah Khamenei e deklaroi para Kuvendit të Ekspertëve. Miliona iranianë dhe të huaj e morën programin përmes satelitit. Ai i bëri të ditur publikut rekomandimin e fundit të përjetshëm të imam

Khomeinit. Përveç zisë ditë e natë, njerëzit nuk kursyen asnjë përpjekje për t'iu betuar me besnikëri liderit të tyre dhe për të mbështetur vendimet e marra nga Ekspertët e Kuvendit.

Kur takuan liderin e ri, ata mundën që ta pengonin armikun dhe mercenarët e tyre të brendshëm për çdo komplot dhe mendim të keq. Pjesëmarrja e njerëzve në lamtumirën e liderit të tyre, kristalizoi mendimin dhe moton më të bukur. Ajetullah Khamenei e përshkruan me zemër të thyer ngjarjen e asaj dite dhe vajtimin e njerëzve.

Ajo ditë u shndërrua në një ditë të madhe zie për botën islame. Zemrat e thyera dhe hidhërimi i asaj dite nuk mbetën vetëm për kombin iraninan.

I gjithë Irani u bë shtëpia e zizë. Në çdo qytet dhe çdo fshat të tij, dhimbja dhe e qara u bënë jehonë. Ajo dëgjohej në çdo rrugë, shesh dhe lagje. Askush nuk mund ta mbarte atë në heshtje.

Universi humbi njeriun e tij unik dhe toka përmbante një xhevahir të veçantë. Disa muaj më vonë, nga fundi i mandatit të dytë të presidencës, Lartësia e tij po përgatitej për të hequr dorë nga kjo përgjegjësi. Ajetullah Khamenei ka thënë: *“Para vdekjes së imam Khomeinit, mandati i presidencës po shkonte drejt fundit. Unë po përgatitesha të largohesha. Herë pas here, disa njerëz më jepnin sugjerime për disa punë. Njerëz të papërgjegjshëm mendonin se ato punë do të më përshtateshin mua. Gjithësesi, unë iu përgjigja*

se nëse imami e bën të detyrueshme për mua një punë të tillë, unë do ta zbatoj, pasi urdhri i imamit është detyrim. Përndryshe, do t'i kërkoj Imamit të mos më detyrojë kaq shumë. Në këtë mënyrë, unë do të mund të angazhohem në punët kulturore."

Imam Khomeini, gëzonte dituri nga mistika, duke e konsideruar ajetullah Khamenein plotësisht të denjë për rolin e drejtuesit, për aq sa aftësitë dhe besimi kanë lidhje. Disa herë, imam Khomeini i ka përmedur këto fakte në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të nënkuptuar. Djali i tij, i ndjeri huxhetul-Islam, haxhi sejjid Ahmed ka thënë: *"Kur ajetullah Khamenei po vizitonte Korenë e Veriut, imami i ndjerë pa raportimin në televizion që përfshinte një numër të madh njerëzish, të cilët u mblodhën dhe i uruan mirëseardhjen atij. Pas kësaj, ai tha se ajetullah Khamenei vërtetë e meritonte të ishte lider."*

Kuvendi i Ekspertëve e zgjodhi ajetullah Khamenein në mënyrë të kujdesshme dhe duke besuar në Allah. Krenar, lartësia e tij, e pranoi atë. Ndërkohë, armiqtë kishin hartuar plane ogurzeza dhe intriguere për epokën e Imamit, duke manifestuar në propaganda të vazhdueshme përmes radios dhe shtypit gjatë ditëve që Imami ishte i sëmurë. Ajetullah Khamenei thotë: *"Pas vdekjes së imam Khomeinit, spektrumi i gjerë i të gjithë armiqve të Islamit kundër luftës së Republikës Islame, nuk e fshehi shpresën që në mungesë të themluesit dhe zhvilluesit të saj, Republika Islame do të humbiste fuqinë për mbrojtje, do të ndihej e dobët dhe e pashpresë..."*

Gjithësesi, koha kalonte dhe gjithnjë e më shumë bëhej e qartë se Kuvendi i Ekspertëve, i udhëhequr nga Allahu dhe i udhëzuar nga imam Khomeini, vërtet që kishin zgjedhur një nga personalitetet më të kompletuara, nga e i cili rruga e Imamit do të vazhdonte. Mesazhi dhe fjalimi i tij i bëri armiqtë të pashpresë.

Referimi Merxhi'jeh është një nga frazat më të famshme në jetën e lartësisë së tij, liderit suprem. Pas vdekjes së disa ajetullahëve të mëdhenj, si: Golpajegani, Mar'ashi Naxhafi dhe Araki, pothuajse ai nuk kishte asnjë bosht referimi, bashkëkohës me Imamin e ndjerë, i njohur dhe i pranuar nga njerëzit. Gjithësesi, myslimanët në Iran patën një brez të ri këmbëngulës përpara tyre.

Pas vdekjes së ajetullah Araki, armiku filloi sërish të shkaktonte probleme. Armiqtë pësuan një dështim të rëndë në politikën që ata përdornin, duke qenë të paditur për zyrën e **Merxhi'jes**, për dijetarët dhe për referuesit në zonën e Kunit dhe për njerëzit e mëdhenj të Iranit. Lideri suprem luajti një rol të rëndësishëm në demaskimin e intrigave të armiqve dhe bëri që kombi iranian të ishte i vetëdijshëm për situatën.

Populli i Iranit përjetoi një dhimbje të thellë kur Imami ndërroi jetë. Ai u bë dëshmitar i asaj ngjarjeje dhe shumë të tjerë e panë atë në televizion. Pse po qanin? Cila ishte arsyeja? Ai ishte një burrë i moshuar, të cilin njerëzit nuk e kishin takuar. Vetëm dijetarët e personalitetet e njihnin atë.

Përse është e gjithë kjo? Iranianët besonin në të; nga thellësia e zemrës së tyre i donin klerikët, burrat besimtarë. Asnjë njeri nuk e urrente atë. Ata e pëlqenin klerikun e vërtetë.

Ata besuan sipas mënyrës së Islamit. Islami i ndihmoi shumë. Islami i lejoi të ishin të lirë dhe të denjë. Islami i liroi nga tirania dhe administrata e korruptuar. Atje ishte një zë i vërtetë i lirisë, sepse lideri i tij ishte klerik.

Përktheu nga anglishtja: Sonila QAZIMI

Teuhidi



Kuptimi i vërtetë i teuhidit është besimi në Njohësin e Gajbit (të së fshehtës).

Teuhid do të thotë shpëtim i njeriut nga adhurimi i çdo gjëje përveç Allahut të Madhëruar.

Teuhidi është drejtimi nga qëllimi më i lartë dhe ngritja e qenies në rrethin e pakufishëm në fuqi dhe urtësi.

Teuhid, në kuptimin e tij të thellë kur'anor, do të thotë drejtimi dhe lëvizja drejt Allahut dhe refuzimi i idhujve dhe i fuqive djallëzore.

Kuptimi i teuhidit është i përgjithshëm dhe përgjithësues gjatë historisë. Ai ka kuptimin e adhurimit të Allahut të Vetëm e të Pashoq.

Teuhidi nuk kufizohet në mendime, sepse ai është çështje e vërtetë, sistem dhe ligj për jetën.

Teuhidi është shtylla kryesore e mendimit dhe pikëpamjes së Islamit.

Fjala Teuhid është simboli i vazhdimësisë së mësimëve të profetëve nga fillimi e deri në fund.

Teuhidi, me gjithë përmasat e tij individuale, shoqërore dhe politike, i realizon fuqinë, krenarinë, civilizimin, përparimin dhe suksesin e plotë të vendeve islame.

Patjetër duhet që të ngrihet flamuri i Teuhidit, në të cilin ftoi Profeti i Islamit dhe që zhduku ndarjen shoqërore.

Kur themi “la ilahe il’lall’llah la sherike lehu”, kjo ka kuptimin se ky teuhid i pastër i shkatërron të gjitha llojet e adhurimeve të tjera dhe realizon triumfin.

Vërtet, thënia e Profetit tonë të dashur e fisnik, Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!): “Thoni: ‘la ilahe il’lall’llah’, S’ka Zot tjetër përveç Allahut që të shpëtoni.” nuk ka kuptimin vetëm për shpëtim politik, shoqëror, shpirtëror a për shpëtim në Ditën e Kiametit, por ka kuptimin e shpëtimit në këtë jetë dhe në Jetën Tjetër.

Të gjitha problemet dhe mjerimet që kanë rënë mbi myslimanët janë si rezultat i moskapjes së tyre me litarin e teuhidit.

Teuhidi na sqaron metodologjinë që duhet të ndjekim me miqtë dhe me armiqtë tanë.

Teuhidi na sqaron mënyrën se si duhet të jetë sistemi shoqëror dhe mënyrën e jetesës që duhet të zbatojmë.

Teuhidi nuk është i lidhur vetëm me jetën pas vdekjes, por besimi në të e udhëheq botën drejt lulëzimit dhe ndërtimit të saktë të kësaj jete.

Mesazhi islam



Sot e shohim më mirë se kurrë etjen e njerëzimit për mesazhin islam, i cili është mesazh i monoteizmit, i spiritualitetit, i drejtësisë dhe i fisnikërisë së njeriut.

S'ka dyshim se mesazhi i vërtetë profetik, monoteizmi islam dhe udha islame, të cilat sjellin lumturi dhe përparim, e çojnë njerëzimin në përsosurinë e vërtetë.

Na akuzojnë për kokëfortësi dhe mosdëgjim të thënieve të sakta, ndërkohë që ne zbatojmë teuhidin, vërtetësinë në thënie dhe asketizmin ndaj dukurive materiale.

Duhet që t'u sqaroni njerëzve të mirat e Islamit, të vërtetat e tij, si dhe kuptimin e lartë të profetësisë dhe të drejtësisë në Islam.

Islami është më i larti dhe asgjë nuk është mbi të. Këtë të vërtetë e ka thënë profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Vetë Islami e ka konstatuar sot këtë të vërtetë, e cila do të vazhdojë të qëndrojë në të ardhmen.

Pastërtia shpirtërore ka qenë një prej synimeve kryesore në të cilën mbështetej profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) në misionin e tij edukativ të pjesëtarëve të ymetit, me qëllim që të formonte (ndërtonte) njeriun e vërtetë.

Sot njerëzia ka shumë nevojë për atë zë që thërriste Profeti i Islamit, zëri që ftonte në monoteizëm dhe në drejtësi mes njerëzve.

Vërtet, profetët u dërguan dhe Librat qiellorë u zbritën për të zbatuar drejtësinë dhe që shoqëria njerëzore të jetonte nën hijen e drejtësisë.

Kur'ani



Kur'ani është flamuri i lartë i Islamit. Myslimanët duhet të kapen fort pas këtij flamuri dhe të mos ndahen kurrë prej tij. Duhet patjetër që Kur'ani të duket në veprat tona, në jetën tonë, në sjelljet tona, në moralin tonë dhe në rrugëtimin e përgjithshëm të ymetit islam.

Përpiquni ta kuptoni Kur'anin dhe ta lexoni atë në formë të rregullt e të disiplinuar.

Lexojeni vazhdimisht dhe çdo ditë Kur'anin, edhe nëse lexoni shkurttimisht. Lexojeni atë duke u përqendruar tek kuptimi i tij.

Kur'ani i jep njeriut mprehtësinë, i frymëzon dijen për njohjen e Zotit dhe e mbron nga gabimet në shumë raste.

Kapja pas Islamit dhe zbatimi i rregullave të Kur'anit është sekret i qëndrimit dhe i fuqisë së sistemit islam.

Kur'ani është burimi i krenarisë së myslimanëve. Kuptimi i tij nuk është i kufizuar vetëm tek leximi dhe besimi në të. Ai është sistemi i plotë për jetën shoqërore.

Ne i quajmë tekstet kur'anore më të fuqishme sesa produktet e mendjeve mposhtëse të ligjvënësve perëndimorë.

Kënaqini vetat tuaja me Kur'anin dhe persiatni mbi të.

Nuk duhet t'ju kalojë asnjë ditë pa lexuar diçka nga Kur'ani me persiatje.

Përpiquni të lexoni çdo ditë nga Kur'ani aq sa të mundeni, sepse leximi i Kur'anit ua shton ndriçimin.

Prej këtij Kur'ani buron besimi i çiltër, me të cilin zbukurohen besimtarët gjatë gjithë historisë.

Vërtet, mirësia e leximit të xhuzeve pa persiatje dhe arsyetim është më e pakët sesa leximi i dy rreshtave që lexohen me persiatje dhe arsyetim.

Kur'ani është i vërteti Vërtetues. Ai na fton që të vaditemi me mësimet nga historia.

Kur'ani i shenjtë nuk është ndikues, veçse me metodologji artistike.

Duhet që Kur'ani të jetë pjesë e mësimëve në shkollat tona. Është detyrë e studentëve që ta mësojnë përmendsh Kur'anin.

Duhet treguar interes për shkencat e Kur'anit dhe për çështjet që kanë lidhje me shkencat e tij.

Kur njeriu të lexojë një ajet Kur'ani, duhet të mendojë thellë në të dhe të nxjerrë kuptimin e tij.

Sa më shumë të shtohen njohuritë e njeriut për Kur'anin, aq më afër tij është ai.

Duhet që hafizat e Kur'anit të përpiqen që ta ruajnë atë që kanë mësuar përmendsh, sepse mësimi përmendsh është një mirësi e madhe.

Dijeni, o ju të rinj, që mësoni Kur'anin, se po grumbulloni një pasuri, e cila kurrë nuk mbaron gjatë gjithë jetës.

Mjerë ju, nëse ata para jush, që nuk besojnë në të, i zbatojnë kuptimet e Kur'anit. Ata do të zhvillohen dhe ju do të qëndroni të prapambetur.

Kur'ani është gjallëruesi i jetës. Ai kujdeset për nevojat e njeriut. Kur'ani është receta më e përkryer për lumturinë njerëzore.

Kur'ani, me gjithë fjalët dhe kuptimet e tij, ka ardhur nga Allahu i Madhëruar. Kjo e bën të

domosdoshëm arsyetimin e thellë në të, zhytjen në thellësi të tij dhe përvetësimin e kuptimeve të tij.

Shumica e fatkeqësive të ymetit islam janë si rezultat i largimit të tij nga Kur'ani.

Kur'ani është si shiu, prandaj përgatitini zemrat tuaja dhe paraqitini ato në zbritjen e shiut, me qëllim që Kur'ani të depërtojë në thellësi të tyre.

Kur'ani nuk është për ta lexuar nëpër qoshe. Ai është për vepra, dije dhe njohje.

Padyshim, tubimet kur'anore dhe leximi i tij janë hyrje për njohjen e kuptimeve të Kur'anit.

Kur'ani është detë i gjerë. Sa më shumë të hyni në të, aq më shumë do t'ju shtohet dëshira dhe mendjet tuaja do të ndriçohen.

Me mirësitë e Kur'anit largohen shumë errësira nga zemra dhe shpirti i njeriut.

Mësojani fëmijëve tuaj çështjet e domosdoshme e të dobishme që i afrojnë ata në kuptimin e Kur'anit, me qëllim që Kur'ani të ngulitet në mendjet e tyre si gdhendja mbi gurë. Mirësinë e kësaj vepre ata do ta shohin në fund të jetës së tyre.

Profeti Muhamed

(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)



Allahu i Madhëruar i ka dhuruar kësaj bote thesarin e shenjtë e më madhështor, që është profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Vërtet, burimi i çdo virtyti, qoftë edhe në formë jo të drejtpërdrejtë, është profetësia e bekuar e profetit Muhamed dhe zbatimi i moraleve të mira nga ana e tij. Këtë gjë e ndien çdo njeri mysliman.

Lindja e profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) është shembulli më i lartë i mëshirës së Allahut për njerëzimin.

Vërtet, prania e këtij profeti fisnik dhe dërgimi i tij me misionin e profetesisë janë mëshirë e vërtetë nga Allahu i Madhëruar për robtë e Tij.

Vërtet, profeti Muhamed dhe çdo profet tjetër, u dërgua me rregulla për ndërtimin e shoqërisë njerëzore dhe për drejtimin e saj. Këto rregulla quhen Sistemi islam.

Vërtet, profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) është njeri shembullor dhe ka vendin më të lartë në mesin e krijesave.

Vërtet, të gjithë myslimanët mbliidhen rreth Profetit fisnik dhe zemrat e tyre brohorasin për të me besim, dashuri dhe mallëngjim.

Dijetarët myslimanë, intelektualët, shkrimtarët, poetët dhe artistët në të gjitha vendet islame duhet të zbulojnë dhe të përhapin imazhin e vërtetë të profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Vërtet, personaliteti i Profetit është qëllimi i shigjetave të mëdyshjes dhe të ofendimeve nga ana e orientalistëve jomyslimanë në Perëndim.

Vërtet, dita në të cilën lindi Profeti dhe në të cilën u ndriçua bota e shkatërruar dhe e errësuar, është fillimi i historisë njerëzore.

Qëllimi i emigrimit të Profetit në Medine ishte që të luftonte padrejtësinë e realitetit shoqëror, ekonomik dhe

politik dhe të këqijat e atij realiteti të përhapura në atë kohë.

Vërtet, dërgimi i profetit Muhamed konsiderohet ngjarje madhështore në historinë e njerëzimit, sepse qëllimi i këtij dërgimi ishte shpëtimi i njeriut, edukimi dhe pastrimi i shpirtit të njerëzve.

Vërtet, dita e lindjes së profetit Muhamed është dita e persiatjes për mirësitë e panumërta e të pafundme të këtij të linduri të begatë.

Mirësia më e madhe e kësaj lindjeje madhështore është paraqitja e monoteizmit dhe e drejtësisë si dhurata më e mirë për shoqërinë njerëzore.

Dërgimi i Profetit është çështje shumë e rëndësishme dhe e meriton studimin dhe persiatjen. Ky dërgim ka specifika të pashoqe.

Sa më shumë që të largohen myslimanët nga parimet e fesë së tyre dhe sa më shumë që të dobësohet interesi i tyre ndaj mesazhit të vulës së profetëve, profetit Muhamed, aq më të ndërlikuara dhe të vështira do t'u bëhen çështjet e jetës përgjatë historisë.

Argumenti i vërtetësisë së atij që thotë: “E dua Allahun.” është ndjekja e Profetit dhe e Kur'anit.

I Dërguari i Allahut ka qenë mësuesi i të parëve dhe i të fundmëve. Melekët e vadisnin dijen e tyre me dijen e tij dhe zemra e tij ka qenë vendi më i lartë i frymëzimit të Allahut.

Personaliteti i Profetit është boshti i unitetit mes myslimanëve, që ne dëshirojmë të realizohet.

Profeti Muhamed bashkëpunonte me thjeshtësi me njerëzit dhe i shihte të gjithë me respekt, larg çdo mendjemadhësie dhe mburrjeje.

Të gjitha qytetërimet, të gjitha shkencat e zhvillimet i detyrohen figurës së profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Namazi



Njeriu mjafton të thellohet në kuptimin e thënieve të namazit e zemra e tij do të bëhet më e ndritshme. Ajo do të marrë përgjigjen.

Zelli i të Dërguarit të Allahut për pastrimin e njeriut ishte nëpërmjet namazit.

Islami, me namazin, agjërimin dhe zekatin e lidh besimtarin me Allahun, forcon zemrat e njerëzve dhe i bën ata të palëkundshëm si malet.

Namazet ditore qëndrojnë mes njeriut dhe harresës. Ato (namazet) e bëjnë atë që të ketë gjithmonë në mendje përmendjen e Allahut të Madhëruar.

Sikur njeriu t'i shikonte këto rekate të caktuara me syrin e ndërgjegjes, do të shihte se ata janë burim i mirësive të shumta.

Namazi e shtyn mbarë ymetin (bashkësinë) që të veprojë për Allahun. Ai i ndalon njerëzit nga të këqijat dhe i afron ata tek shpëtimi dhe fitorja.

Namazi, me formën e tij të harmonizuar, është shembulli më i plotë dhe më i përkryer për dhikrin (përmendjen e Allahut).

Namazi është ai që i jep njeriut udhëtimin shpirtëror dhe përqendrimin kur përjeton gjendjet e ngritjes shpirtërore.

Namazi është ai që i bie këmbanës së rrezikut në veshët e njeriut, kur kalon në gjendje hutimi.

Namazi është doza që jep fuqi dhe shërim në vështirësi, në fatkeqësi dhe në sakrifica.

Namazi është ai që na ndihmon me imunitet, gris perdet e fantazive dhe na ndriçon rrugët dhe horizontet.

Kur e fal namazin me vëmendje dhe me zemër, ndikimi i tij nuk kufizohet vetëm me atë çfarë mbjell ai në zemrën e namazfalësit, por ndikimi i tij do të zgjerohet për të mbushur me dritë gjithçka që e rrethon atë (namazfalësin).

Sa më shumë ta shtojë përmendjen (dhikrin) namazfalësi, aq më shumë do të zhduken errësirat rreth tij, do të largohet egoizmi, smira dhe do të shkëlqejë drita e shpëtimit në ballin e jetës.

Namazi e çliron njeriun prej prangave të errësirave, të epsheve dhe të zemërimit. Ai e lartëson atë drejt së vërtetës së lartë dhe drejt të mirës gjithpërfshirëse.

Namazi i mbushur me frikë dhe me praninë e zemrës, lind Xhenetin e vërtetë në zemrën e namazfalësit, i cili dalëngadalë shtrihet në të gjithë jetën.

Namazi në Islam është namazi më i plotë dhe më i mrekullueshëm.

Namazi është dokumenti më i fortë i njeriut dhe thesari i tij që kurrë nuk mbaron në përballjen e tij me shejtanin.

Namazi është baza kryesore e fesë. Ai duhet të ketë pozitën më të rëndësishme në jetën e njerëzve.

Namazi është detyrim. Ai është koha më e çmuar për t'u lidhur me Allahun e Madhëruar.

Duhet që të gjithë të njihen me sekretet dhe simbolet e namazit dhe të përfitojnë prej kuptimeve të tyre.

Duhet që namazi të mos e humbasë prioritetin e tij, qoftë edhe në fushëbeteja.

Njeriu, gjithmonë ka nevojë për namazin dhe në fushat e rrezikut, ka edhe më shumë nevojë për të.

Namazi është detyrimi më i madh ndaj Allahut për të hulumtuar të vërtetën.

Namazi është dhuratë e pashoqe dhe burim i pashtershëm për mirësitë.

Namazi është portë e hapur për në Xhenetin e gjerë, të cilin e mbulon pastërtia.

Prindërit duhet t'i udhëzojnë fëmijët e tyre, me thënie dhe me vepra, drejt namazit.

Namazi përbën burimin gufues me mirësi të shumta për zemrën dhe shpirtin e namazfalësit.

Namazi është ai që fryn në shpirtin e njeriut nxitjen për mirësi, përbuzjen e kënaqësive materiale, mbështetjen tek Allahu dhe zbatimin e urdhrave të Tij.

Namazi është më shumë, sesa detyrë individuale. Ai ka një rol të madh dhe vendimtar në drejtimin e çështjeve individuale dhe shoqërore.

Vërtet, adhurimet islame, me në krye namazin, konsiderohen si kurë për mendjemadhësinë dhe egoizmin në shpirtin e njeriut.

Vlerësojeni rëndësinë e namazit. Ai është një e vërtetë e shenjtë dhe dritë ndriçuese që i është dhuruar ymetit të Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Namazi duhet të falet në kohën e tij dhe të konsiderohet si burim i frymëzimit për të vërtetën dhe udhëzimin.

Është fatkeqësi e madhe që një njeri të jetojë në një rreth islam dhe të mos falë namaz.

Të gjitha radiot dhe televizionet duhet ta konsiderojnë namazin si një çështje të domosdoshme që duhet mësuar.

Prej misionëve të domosdoshme që rëndojnë mbi supet e besimtarëve dhe të punëmirëve prej robve të Allahut është falja e namazit, të cilës Allahu i ka kushtuar një rëndësi të veçantë në Kur'anin e shenjtë.

Vërtet, namazi që falet me gjithë shpirt, me pendim dhe me praninë e zemrës e bën namazfalësin që të jetë në harmoni me të gjithë botën krijuese.

Zekati dhe sadakaja



Zekati është e drejtë financiare që e pastron njeriun. Dhënia e kësaj të drejte financiare e pastron shpirtin e njeriut nga papastërtitë e ndryshme.

Zekati është si namazi. Ai ka nevojë për përpjekje të palodhshme dhe për sakrifica të vërteta e të vazhdueshme.

Është detyrë e secilit që gjen në veten e tij mundësinë e sqarimit dhe të përhapjes së çështjes së zekatit që të përveshë krahët dhe të veprojë.

Haxhi dhe dimensionet e tij



Detyrimi i haxhit, që kryhet çdo vit, ka rolin e ushqimit të bashkësisë me mësimin e monoteizmit dhe të unitetit.

Haxhi i Ibrahimit është ai, në të cilin, lëvizja drejt monoteizmit dhe drejt bashkimit, zë vendin e parë në shpirt në të gjitha kohërat.

Shtëpia e Allahut është qendra e zbatimit të monoteizmit dhe e gjithçkaje që Ai simbolizon.

Haxhi është pranvera e zemrave dhe e shpirttrave. Ai është stina e gjelbërimit të jetës monoteiste në zemrën e çdo myslimani që arrin në mikat [vendi ku vishet rroba e haxhit (ihrami)].

Njohja e madhësisë së Allahu dhe e mëshirës së Tij në haxh do të thotë logjistikim dhe meditim në ngritjen e themeleve të kësaj shtëpie që është Shtëpia e Allahut të Madhëruar.

Haxhi është dukshmëria e ymeti islam dhe shkolla e asaj sjelljeje, nga e cila duhet të drejtohet ky ymet i madh për të arritur lumturinë e tij.

Në adhurimin e haxhit janë të trupëzuara kuptimet e dashurisë, të miqësisë, të harmonisë, të familjarizimit, të vëllazërisë, të rezistencës dhe të palëkundshmërisë përballë armiqve.

Sa më shumë flitet për haxhin, aq më shumë përhapet aroma shpirtërore në çdo vend.

Haxhi është një detyrim i përveçëm i mbushur me të fshehta.

Cilido që krenohet me shërbimin dhe administrimin e kësaj Shtëpie (Qabes), duhet ta falënderojë Allahun për këtë.

Vërtet, çështja e haxhit është më e thellë nga ajo që ne kemi kuptuar deri më sot.

Shtëpia e shenjtë (Qabja) është vendi, me të cilin ndriçohen zemrat dhe trupat me anë të dritës së besimit dhe të shpresës.

Grumbullimi i myslimanëve në ditët e haxhit ka një qëllim, që është hulumtimi dhe meditimi për të ardhmen e ymetit islam.

Ai është shpirti i tij dhe kuptimi i tij.

Kushdo që përpiqet ta shndërrojë haxhin në çështje politike për ta harmonizuar me politikën e fuqive të mëdha, është tradhtar i këtij detyrimi të shenjtë islam.

I lutem atyre që janë mbarësuar të shkojnë në Mekën e Shenjtë që kohën e haxhit të mos e marrin si kohë tregtie.

Haxhi është më lart në pozitë, sesa çështjet e pavlera të kësaj dynjaje.

Zemrat e besimtarëve, në ditët e haxhit, kërkojnë që gjurmët dhe kujtimet t'i lidhin me vetat e tyre, me gjendjet e ndritura shpirtërore.

Haxhi shfaq në ekranin e tij një pasqyrim të plotë për jetën e të gjithë njerëzve.

Jeta, sipas mësimëve të haxhit, është ecje e përhershme drejt Allahut.

Haxhi është mësim praktik dhe konstruktiv, i cili na vizaton rrugën e jetës tonë në formën e ndritur praktike.

Detyrimi i haxhit për çdo vit përbën një ndodhi madhështore, e cila e meriton interesimin nga e gjithë bota islame.

E para dhuratë e haxhit për atë që do të dijë të vërtetën dhe që do të shpenzojë aftësitë e frymëzuara nga Allahu për të kuptuar të dukshmet, është njohja e plotë.

Asnjë dukuri fetare nuk mund t'i paraqesë ymetit islam një sistem të plotë njohjeje ashtu siç ia paraqet haxhi.

Legjitimiteti i detyrës së haxhit dhe sistemimi i ritualeve të tij përmbajnë argumente madhështore dhe shenja të mëshirës.

Udhëzimi i tubimeve madhështore të haxhinjve është detyrë e dijetarëve të fesë, e shoqëruesve të haxhinjve dhe e përgjegjësve të anës kulturore.

Vërtet, popujt myslimanë, elita e grumbulluar rreth Qabes së Shenjtë dhe në vendet e begata të Tokës së Shpalljes, sot kanë nevojë më shumë se kurrë për kuptimet e haxhit, për anën shpirtërore të tij dhe për fuqinë që ka ai.

Agjërimi dhe muaji i Ramazanit



Adhurimi i agjërimimit dhe adhurimet e tjera kanë si bosht kryesor njeriun, i cili duhet të mposhtë epshet dhe egon e tij.

Agjërimi me nijet është xhevahir ndriçues, i cili i jep njeriut madhështi dhe ia hijeshon shpirtin me fisnikëri.

Agjërimi është nder, mirësi dhe një kohë shumë e çmuar për ata që mbarësohen në kryerjen e tij.

Vështirësitë, me të cilat përballlet njeriu gjatë agjërimimit, nuk janë asgjë përballë dobisë së madhe.

Një njeri që dëshiron të përshkojë rrugën e lartësisë e të përsosurisë në jetën e tij, mund ta fitojë këtë nëpërmjet bindjes se e gjitha kjo vjen nga agjërimi.

Vërtet, i gjithë qëllimi i agjërimimit të muajit të Ramazanit është që të bëhemi të devotshëm dhe kjo është në dorën tonë.

Agjërimi i këtij muaji është mjete që e ndihmon njeriun për të ndjekur rrugën e udhëzimit.

Devotshmëria është një prej qëllimeve të agjëritit dhe ajo është fruti më i madh që vilet në muajin e Ramazanit.

Agjërimi është pjesë prej mikpritjes së Allahut, prandaj shfrytëzojeni sa më shumë.

Në muajin e Ramazanit besimtarët mblidhen rreth tryezës mikpritëse të Allahut.

Përgatituni sepse dy muajt, Rexheb dhe Sha'ban, e përgatisin zemrën e njeriut për të hyrë në muajin e Ramazanit.

Vërtet, muaji i Ramazanit në çdo vit është një pjesë nga Xheneti që Allahu e vendos në Xhehenemin e ndezur të dynjasë.

Vërtet, mësimi më i madh në muajin e Ramazanit është formimi (ndërtimi) i vetvetes.

Muaji i Ramazanit është si shiu i mëshirës i cili bie në çdo vend të jetës tonë dhe pastron ato gjynahe që kanë bërë duart tona.

Sot është fillimi i muajit të Ramazanit të bekuar. Ai mund të jetë i bekuar për çdo besimtar dhe mund t'i sjellë atij mirësi, jo vetëm për një vit, por për gjithë jetën e tij.

Ai njeri, i cili falë mirësisë së muajit të Ramazanit, fiton fuqinë për të mposhtur egon dhe epsheet e tij, me të vërtetë që ka realizuar diçka madhështore që duhet ruajtur.

Produkti i muajit të Ramazanit është kapital prej devotshmërisë, i cili pastron zemrat dhe shpirtrat tanë.

Nata e Kadrit është nata e vilajetit, nata e zbritjes së Kur'anit dhe nata e Ehli Bejtit (paqja qoftë mbi ta!).

Duhet që muaji i Ramazanit të na afrojë me ndjenjën e përgjegjësisë, të cilën e kërkon Islami nga të gjithë myslimanët përballë çështjes delikate të varfërisë.

Ringjallja dhe Kiameti



Ne do ta kuptojmë Ditën e Kiametit kur të shohim gjëra të habitshme në regjistrin e punëve tona.

Njeriu do të habitet në Ditën e Kiametit dhe do të pyesë për kohën e veprimit të punëve të tij të habitshme.

Dijeni se asnjë prej përpjekjeve dhe vështirësive tuaja nuk humbet tek Allahu i Madhëruar.

Allahu i Madhëruar do të na tubojë Ditën e Kiametit dhe do të na pyesë. Prandaj, duhet t'i përgatisim përgjigjet për atë Ditë.

Prej çështjeve parimore dhe themelore në pikëpamjen e Islamit është vazhdimësia e jetës pas vdekjes.

Vdekja është hyrje në një fazë të re dhe nuk është zhdukje për njeriun.

Ne duhet të bëjmë përpjekjen e duhur, që të meritojmë të jemi prej të përmendurve tek Allahu dhe jo të na thuhet: "*Ne ju harruam juve.*".

Vitet e jetës dhe orët e saj kalojnë si retë. Këto momente do t'i kujtoni në skenën e Kiametit.

Njiheni vlerën e çdo momenti prej momenteve të jetës dhe shfrytëzoni orët e moshës tuaj për të bërë punë të mira.

Njeriu që e ka pastruar veten e tij, kur të shkojë në Botën Tjetër, do të ketë fund të pëlqyer.

Vërtet, vdekja nuk është fundi i jetës, por ajo është porta e Jetës së Përhershme dhe fillimi i Jetës Tjetër.

Sistemi islam e konsideron këtë jetë dhe Jetën Tjetër të lidhura me njëra-tjetrën, prandaj duhen ndrequr që të dyja.

Ajo që Allahu i Madhëruar kërkon nga njeriu në këtë dynja, është që ai ta përgatisë veten e tij për Jetën Tjetër.

Adhurimi



Nuk ekziston "*ne*", sepse ne jemi të pafuqishëm. Çdo gjë është nga Allahu dhe nga Vullneti i Tij.

Nëse bashkësia është e përkushtuar dhe e devotshme, padyshim se ajo do ta vazhdojë rrugëtimin e saj në udhën e besimit, të përprarimit dhe të adhurimit të Allahut të Madhëruar.

Vërtet, ndryshimi moral dhe shpirtëror, drejtimi kah pastërtia dhe humanizmi dhe adhurimi i Allahut, garantojnë lumturinë e njerëzve.

Duhet që myslimanët të kthehen tek Islami, në të cilin shkëlqen monoteizmi dhe duket qartë dhe fort adhurimi i një Zoti të Vetëm e të Pashoq.

Vlera më e lartë që i dallon të Dërguarit është adhurimi i Allahut nga ana e tyre dhe mësimi që ata i dhanë njerëzimit për adhurimin nëpërmjet veprave të tyre.

Liria është ana tjetër e detyrimit. Gjithashtu, liria është e drejta e jetës dhe ajo përfaqëson premisën (kreun) e adhurimit.

Udhëzimi i Isait, të birit të Merjemes është udhëheqja drejt adhurimit të Allahut të Madhëruar.

Duhet që shenjat e adhurimit të Allahut të Madhëruar të duken në fytyrën e secilit prej nesh.

Vërtet, sjellja e imam Hysejnit (paqja qoftë mbi të!) ka qenë e mbushur me adhurim dhe dorëzim të plotë para urdhrave të Allahut.

Qëllimi i të gjithë profetëve ka qenë udhëzimi i njerëzve në rrugën e drejtë dhe **rrugë e drejtë** do të thotë adhurim.

Fushat e jetës shoqërore dhe politike të njeriut duhet të jenë mejdani i adhurimit të Allahut.

Vërtet, njohja më e mirë e njeriut në etalonin islam është adhurimi i Allahut të Madhëruar.

Duhet që të pasojmë hazreti Merjemen (paqja qoftë mbi të!) në rrugën e adhurimit dhe në rrugën e drejtë.

Sa më shumë që të thellohemi në rrugëtimin e monoteizmit dhe në rrugën e adhurimit të Allahut, aq më shumë do të na qartësohet e keqja e të padrejtëve dhe e tiranëve.

Uniteti



Vërtet, njerëzia është një dhe e pandarë. Dhunimi i një personi prej bijve të Ademit konsiderohet dhunim për mbarë njerëzimin.

Duhet që myslimanët ta vendosin moton e unitetit dhe të bashkëpunimit mes tyre në krye të shqetësimeve të tyre, sepse sot ajo moto është më e dobishmja për ata.

Nëse popujt dhe qeveritë islame i mbulon ndjenja e butësisë ndaj njëri-tjetrit, nuk do të ketë vend për frikën që e kanë hedhur kolonizatorët në zemrat e disa popujve dhe udhëheqësve.

Fryti i parë i unitetit është ndjenja e fuqisë tek njeriu. Pasoja e parë e përçarjes është boshllëku (zbrazëtia) i njeriut në brendinë e tij.

E vërteta kur'anore thekson se nëse njeriu përqendrohet në fuqitë e tij të brendshme, pra tek besimi, vullneti, fjala e përbashkët dhe vetësakrificimi, asnjë fuqi tjetër nuk do të qëndronte përballë tij.

Një prej sadakave të vazhdueshme të revolucionit islamik, i cili u realizua falë mirësisë së gjenialitetit të imam Khomeinit, është specifikimi i ditëlindjes së profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) si ditë e unitetit.

Uniteti islam është shpresë dhe qëllim. Disa e përjetojnë këtë shpresë me tërë qenien e tyre dhe disa të tjerë e marrin vetëm si parullë pa qenë seriozë në realizimin e këtij uniteti.

Unë kam mendimin dhe besoj se uniteti i myslimanëve është domosdoshmëri jetësore dhe nuk është parullë.

Vërtet, uniteti mes popujve myslimanë nuk i mohon mospajtimet e pranishme dhe as ndryshimet që gjenden në kulturat dhe zakonet që ndjekin shoqëritë myslimane.

Uniteti i popujve myslimanë ka kuptimin që ata të kenë një qëndrim të përbashkët në lidhje me çështjet e botës islame dhe të bashkëpunojnë mes njëri-tjetrit.

Vërtet, ndryshimi është çështje e natyrshme në shoqërinë njerëzore. Por, ky ndryshim, në pikëpamje dhe mendime nuk duhet ta dobësojë fuqinë e unitetit dhe as ta prishë harmoninë mes bijve të një shoqërie.

Armiqtë i shtuan përpjekjet e tyre kur panë diellin e unitetit islam në kulmin e lindjes në botën islame.

Vërtet, unitetit duhet ngritur mbi bazat e Islamit dhe me kapjen pas litarit të Allahut dhe jo mbi legjenda e paganizma.

Ekzistenca e ymetit islam mbështetet tek uniteti i bazuar tek Islami.

Uniteti është arma më e madhe kundër arrogancës globale.

Sikur ymeti islam, i cili përbëhet prej një miliard e gjysmë myslimanësh, të bashkohej në çështjet e tij esenciale, do të shihnim një superfuqi madhështore në këtë ekzistencë.

Kuptimi i unitetit islam është i qartë dhe nuk ka kuptimin e shkrirjes së të gjithë medh'hebeve në një medh'heb të vetëm.

Armiqtë e kundërshtojnë gjithmonë unitetin dhe bashkimin e myslimanëve. Edhe historia e dëshmon këtë të vërtetë.

Ka ardhur koha që bota islame ta ruajë unitetin e saj dhe të rreshtohet në një rresht të vetëm përballë armikut të përbashkët.

Vërtet, thirrja jonë për unitet islam është themeli i krenarisë, i fisnikërisë dhe i stabilitetit të shoqërisë.

Urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja



Urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja është detyrë e përgjithshme.

Urdhërim në të mirë do të thotë t'u drejtohesh të tjerëve për të bërë vepra të mira. Ndalim nga e keqja është t'i ndalosh të tjerët nga kryerja e punëve të këqija e të shëmtuara.

Mallkimi i Allahut bie mbi atë që i urdhëron njerëzit në të mirë dhe nuk e vepron vetë dhe që i ndalon të tjerët nga e keqja dhe ai vetë e bën të keqen.

Urdhërimi në të mirë është një lloj bashkëpunimi dhe mbikëqyrje e përgjithshme për të përhapur të mirën dhe për të ndaluar të keqen dhe shkatërrimin.

Kur në mesin e shoqërisë përhapet urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja, atëherë kjo çon në përfundimin që gjynahu, në pikëpamjen e njerëzve, të konsiderohet gjynah deri në fund të kësaj jete.

Nëse neglizhohet urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja, në shoqëri përhapen veprat e këqija dhe kjo do t'i hapte rrugën veseve.

Duhet që populli t'u kërkojë përgjegjësve që të bëjnë punë të mira. Këtë të mos e bëjnë nëpërmjet thirrjes dhe lutjes, por nëpërmjet urdhrit.

Ka të këqija të përhapura në mesin e shoqërisë që duhet të ndalohen. Prej tyre, është shpërdorimi i pasurive të përgjithshme...

Ndalimi nga e keqja me gjuhë (me fjalë) është detyrë e të gjithëve dhe kurrë nuk duhet të lihet, sido që të jetë situata.

Sistemi islam është sistem i urdhërimit në të mirë dhe i ndalimit nga e keqja. Kjo është detyrë e padiskutueshme për të gjithë.

Urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja nuk kufizohet vetëm me një shtresë të shoqërisë.

Mjerë ju, nëse i drejtoheni një personi prej elitës me lutje... Ju duhet ta ndaloni, duke i thënë: "Mos e bëj këtë!" Gjendja e kryelartësisë duhet të përfaqësohet tek urdhërimi dhe tek ndalimi.

Të gjithë duhet të urdhërohen në të mirë dhe të ndalohen nga e keqja, edhe sikur ai person të jetë i rëndësishëm.

Urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja është një prej detyrave dhe nuk përmban as tolerancë dhe as turp.

Të rinjtë duhet ta ndalojnë të keqen kudo që ta shohin atë.

Ndalimi nga të këqijat ka nevojë për vullnet, vendosmëri, fuqi dhe guxim.

Çështja e urdhërimit në të mirë është detyrë e vazhdueshme për myslimanët. Jeta e shoqërisë është e lidhur me praninë e urdhërimit në të mirë dhe të ndalimit nga e keqja.

Revolucioni i Hysejnit (paqja qoftë mbi të!) ishte për të kryer një detyrë të madhe, e cila ishte rikthimi i Islamit dhe i shoqërisë islame në rrugën e drejtë. Kjo është vërtetësi madhështore e urdhërimit në të mirë dhe e ndalimit nga e keqja.

Vërtet, urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja, në pamje të përgjithshme, janë më të rëndësishëm se xhihadi.

Feja është e fortë dhe e palëkundur me praninë e urdhërimit në të mirë dhe të ndalimit nga e keqja. Mbi këto të dyja mbështetet edhe xihadi.

Zbatojini faktorët e vazhdimit të Islamit. Prej faktorëve të vazhdimit është çështja e Ashurasë dhe e urdhërimit në të mirë dhe e ndalimit nga e keqja.

Fetë



Fetë e ndalojnë njeriun që të mos bjerë në greminën e humbjes dhe e bëjnë atë që të mos e humbë frerin e vetvetes dhe të rrëshkasë në këtë greminë.

Përse duhet që Islami dhe Kristianizmi ta luftojnë njëri-tjetrin?! Kurrë nuk ka konflikt mes feve. Ato kanë një harmoni bashkëjetese mes tyre.

Thirrja që mbartin fetë e Allahut e drejtojnë njerëzimin kah paqja, siguria dhe stabiliteti dhe nuk e drejtojnë atë kah acarimi, ligësia, varfëria, lufta, shtypja etj.

Vërtet, fetë e Allahut, që në fillim të shfaqjes së tyre, pra që në krijimin e njeriut, e deri në ditët e sotme kanë përjetuar armiqësinë e tiranëve dhe të të padrejtëve.

S'ka dyshim se shumica e virtyeteve të larta të përhapura në mesin e njerëzve e kanë burimin tek fetë e Allahut, tek mësimet e të Dërguarve dhe tek Shpalljet e Zotit.

Sot njerëzia ka nevojë për pastërtinë dhe njohjet e qarta, të vërteta dhe tolerante të Islamit, të cilat i kupton dhe anon kah ato çdo zemër dhe shpirt i drejtë e i pastër.

Tek të gjitha fetë, të gjitha medh'hebet, deri edhe tek qytetërimet në botë, ka gjëra që njerëzit duhet t'i zbatojnë dhe këto janë vlerat.

Shejtani, në logjikën e feve, veçanërisht në fenë islame, përfshin të gjitha të këqijat.

Vërtet, Islami vazhdon të jetë feja e rregullit. Duart devijuese e falsifikuese nuk kanë arritur t'i bëjnë asgjë atij. Ai bazohet në burime të besueshme.

Ju jeni më të lartit, për shkak se jeni pjesëtarë të asaj feje, e cila ka aftësinë e shpëtimit të njerëzimit. Ju jeni më të lartit, sepse jeni pjesëtarë të asaj feje, e cila ka mundësinë që në dorën e çdo njeriu të vendosë pishtarin e udhëzimit dhe t'i lumturojë njerëzit duke i çuar në bregun e sigurisë dhe të përsosurisë.

Udhëheqësia e fesë nuk është vetëm për zemrën, shpirtin dhe veprat individuale të njeriut, por ajo përfshin të gjithë jetën dhe këtë e dëshmojnë të gjitha fetë.

Të gjitha fetë dhe medh'hebet besojnë në vërtetësinë e ardhjes së shpëtimtarit nga ana e Allahut, për të shpëtuar njerëzimin nga padrejtësia dhe shtypja.

Të gjitha kulturat njerëzore, të gjitha sistemet ekonomike dhe të gjitha metodologjitë e gabuara të jetës një ditë do të udhëhiqen nga qeverisja e fesë së Allahut.

Vërtet, feja i pushton zemrat, të cilat, kurrë, nuk pushtohen me shpatë e me dhunë. Zemra duhet të kuptojë dhe të besojë me bindje dhe me dëshirë.

Vërtet, dija nuk i shërben njeriut, nëse ai nuk është i mbushur me synim dhe besim dhe këto nuk mund të gjenden, veçse tek fetë.

Të gjitha fetë e Allahut e konsiderojnë dynjanë vend edukimi dhe vend provimi për njeriun.

Ju e shikoni sot që mendimi më i vazhdueshëm dhe më i qëndrueshëm është ai mendim njerëzor, të cilin e zbukuron feja. Ai do të qëndrojë i tillë përjetë.

Predikimi



Duhet që predikimi juaj të jetë më shumë për bindjen dhe dorëzimin e zemrave Allahut të Madhëruar.

Sikur myslimanët t'i rregullonin veprat dhe sjelljet e tyre shoqërore dhe individuale që të ishin në përputhje me mësimet e fesë, ata do kryenin predikimin më të lartë islam.

Vërtet, predikimi më i mirë për çdo pikëpamje është zbatimi i saj në realitet.

Ai që fsheh dijen e tij dhe nuk e përhap atë për të mësuar, predikuar, apo vepruar, sigurisht që dija e tij do të jetë si kandili i mbuluar, pra i padobishëm.

Është bërë shumë e qartë tek të gjithë se predikimi është misioni bazë i dijetarëve të fesë.

Predikim do të thotë përçarje (ijsal). Nëse ne arrijmë ta çojmë mesazhin e Allahut në zemra, e kemi kryer këtë mision të madh.

Duhet që predikimi të burojë nga të menduarit, sinqeriteti dhe vlerat shpirtërore. Kjo do të thotë se ai duhet të burojë nga burim ndriçues.

Prej gjërave të rëndësishme në predikim është që t'u përgjigjeni paqartësive të pyetësve.

Një prej shërbimeve që na bëjnë armiq të është se ata na tërheqin vëmendjen ndaj çështjeve ku duhet të përqendrohemi gjatë predikimit tonë.

Duhet që qendrat e posaçme të predikimit dhe të informacionit të derdhen sa më shumë mund e sakrificë në drejtim të ndreqjes së kulturës së përgjithshme.

Thirrja



Thirrja islame përfaqëson përhapjen e urtësisë në mbarë rruzullin tokësor përgjatë gjithë historisë.

Thirrja që mbartin fetë e Allahut e fton njerëzimin në paqe dhe siguri dhe jo në mosmarrëveshje, fatkeqësi e varfëri.

Thirrja për tek e vërteta dhe tek e drejta nuk sosit.

Sot, njerzia ka nevojë për spiritualitetin, pastërtinë dhe njohuritë e sakta, të qarta dhe tolerante të Islamit. Ky është shkaku që thirrja islame ka gjetur shumë përkrahës.

Thirrja islame përmban elementë tërheqës, depërtues dhe shpresues për mbarë popujt.

Sigurisht, thirrja islame është krenari për çdo njeri që e përhap këtë thirrje. Allahu i Madhëruar na ka mirësuar me mirësinë e Tij dhe na ka bërë të mundur që t'i udhëzojmë njerëzit në rrugën e Tij.

Metoda e xhihadit është vendosur me qëllimin e heqjes së pengesave, që thirrja të gjejë rrugën për të hyrë në zemra.

Thirrja e besimtarëve të devotshëm e të sinqertë, qoftë me gjuhë apo me vepra, është ajo që e ngulit Islamin në zemra.

Prej kushteve të përhapjes së thirrjes, në mesin e popujve dhe të kombeve, është që thirrja të jetë logjike dhe e arsyeshme.

Ymeti islam



Për hir të mirësive të Islamit, ymeti islam sot duhet të jetë si pishtari ndriçues që ndriçon rrugët e njerëzimit.

Duhet që bota islame të grumbullojë fuqitë e saj dhe të mendojë seriozisht për rrugëtimin e saj. Myslimanët duhet të vendosin bazat e tyre, idetë e tyre, sakrificat e pikat bashkuese, të cilat përfaqësojnë madhështinë e ymetit islam.

Shpifjet djallëzore se Islami është shkak i prapambetjes i përhapin ata që kanë si qëllim largimin e ymetit islam nga origjina e tij, që ata të udhëheqin ashtu siç dëshirojnë.

Rajoni, në të cilin jeton ymeti islam, është më i rëndësishmi në faqen e tokës.

Përderisa veprat e besimtarëve në mesin e ymeti islam janë të shoqëruara me Islamin dhe me morale të larta, aq më i dashur bëhet Islami në sytë e njerëzve dhe atyre u shtohet dëshira për të.

Vërtet, Islami i dhuron ymetit islam dhe udhëheqësve të myslimanëve fuqi, krenari, trimëri, perceptim dhe vigjilencë në rrugën e tyre.

Shoqëria islame



Shoqëria islame e ka përgatitur veten për përpjekje më të larta dhe më të vështira se sa përpjekjet e zakonshme të shoqërive të tjera.

Qëllimi dhe synimi i lëvizjes së shoqërisë islame në të gjitha fushat është formimi i një shoqërie të drejtë.

Prijësi i besimtarëve (paqja qoftë mbi të!) ia kushtoi jetën e tij udhëzimit dhe ndërtimit të shoqërisë islame.

Vërtet, shoqëria islame për të cilën përpiqemi, është ajo shoqëri në të cilën shpërthejnë dhe punësohen të gjitha thesaret mendore, ideologjike dhe njerëzore.

Duhet që rrugëtimi i shoqërisë islame të jetë në drejtim të kundërt me arrogancën dhe dominimin mbarëbotëror.

Revolucioni i imam Hysejnit (paqja qoftë mbi të!) ishte që ta kthente Islamin dhe shoqërinë islame në vijën e drejtë. Ai ishte revolucion kundër devijimeve të rrezikshme në shoqërinë islame.

Duhet që shoqëria islame të përpiqet për realizimin e drejtësisë. Nëse nuk gjendet drejtësi, ajo përpiqet në realizimin e saj.

Nëse shoqëria islame arrin ta skalitë veten e saj në atë formë që e do Islami, asnjë fuqi në botë nuk mund të përballlet me të.

Të drejtat e njeriut



Ne ecim në rrugën që ka vizatuar Islami. Ajo është rruga në të cilën nuk gjendet padrejtësi dhe as shkelje e të drejtave të njerëzve.

Ai që e akuzon sistemin islam, i cili ka ardhur për zhdukjen e shkatërrimit, të padrejtësisë dhe racizmit në botën e mbushur me shtypje, është armik apo i mashtruar nga armiku.

Të drejtat e njeriut janë ato që i ka thënë shumë qartë prijësi i besimtarëve.

Me rregullat e tij, Islami mbron të drejtat e njeriut, qofshin këto rregulla gjykuese, ndëshkuese, civile, të përgjithshme apo edhe çështje politike.

Ne do të vazhdojmë të mbrojmë të drejtat e njeriut dhe nuk interesohemi se çfarë thotë kjo Organizatë e Kombeve të Bashkuara apo aksh komision ndërkombëtar.

Ne i mbrojmë të drejtat e njeriut, sepse Islami na urdhëron për këtë. Kjo, sepse të drejtat e njeriut janë prej

themeleve të Islamit, kurse ato që propozojnë të tjerët janë mashtrime dhe gënjeshtër.

Popullin tonë nuk e gjuhëzuan, por ai i gjuhëzoi ata, ashtu siç është edhe sot i palëkundshëm përballë elementeve dyfytyrakë, të cilët pretendojnë se mbrojnë të drejtat e njeriut.

Familja islame



Duhet ta forcojmë familjen dhe ta bëjmë atë qendër të dashurisë, të pastërtisë dhe të dhembshurisë.

Duhet që të gjithë ta konsiderojnë veten e tyre të detyruar në solideratitetin me vështirësitë që kalon çdo familje myslimane, e cila përballet me dhimbjen, privimin, varfërinë dhe problemet e ndryshme.

Islami ka vendosur në familje dy pjesë të ngjashme me dy porta. Nëse këto dy pjesë vazhdojnë të jetojnë me ato kufij që ka caktuar Islami, atëherë ato do të formojnë një familje të dashur, të dhembshur, të bekuar dhe të dobishme.

Edhe pse familja përbëhet nga burri dhe gruaja, të cilët ndikojnë në formimin e familjes, stabiliteti i mjedisit familjar është për hir të mirësive të femrës dhe të natyrës së saj.

Edukimi



Rruga e Allahut është rruga e krenarisë dhe e dinjitetit, është rruga e mirëqenies dhe rruga e edukimit të drejtë të shpirtave.

Nëse nuk gjendet edukues në shkollë apo është joaktiv, pikëpamja jonë për të është njësoj si ajo shkollë pa mësues.

Nuk ka shpresë, veçse tek edukimi. Prandaj kini kujdes që çështjet e edukimit të mos bien në dorën e të paditurve me karakter të ashpër, fanatikët e sëmurë, të cilët nuk i njohin parimet e edukimit.

Mësuesit kanë një përgjegjesi të rëndë mbi supe. Ju bashkëpunoni me shtresën më krenare të shoqërisë dhe me shtresën më ndikuese ndaj thirrjeve dhe propagandimeve. Ajo është shtresa e rinisë.

Mësuesi kryen punën më të mirë dhe më të lartë që është mësimi, edukimi dhe formimi i njeriut.

Unë shpreh respekt për të gjithë ata që punojnë dhe përpiqen me të gjitha format, me qëllim mësimin dhe edukimin e njerëzve.

Mësimi dhe edukimi që zhvillohen me vërtetësi dhe sinqeritet kanë një pozitë të lartë. E lusim Allahun e Madhëruar që t'i mbarësojë të gjithë mësuesit dhe edukuesit.

Duhet që sektori i edukimi të ngarkohet me shërimin e neglizhencës dhe përtacisë mendore që në moshën fëmijore, nëpërmjet mësimin të shëndoshë.

Plogështia mendore largohet me anë të veprimtarive në sektorin e edukimit dhe të mësimin.

Vërtet, besimi i njerëzve përballet me lëkundje dhe paqëndrueshmëri. Duhet që kjo çështje të ruhet në sektorin e mësimin dhe të edukimit, duke filluar përpjekjet që në moshën fillestare.

Duhet që sektori i mësimin dhe i edukimit t'i udhëzojë të rinjtë që gjithë ekzistencën e tyre ta vënë në shërbim të mësimin, të hulumtimit dhe të edukimit.

Duhet që çdo mësues që jep mësim në qytet apo në fshat, të japë mësim njësoj sikur të ketë të pranishëm një kontrollues që mbikëqyr metodën e mësimdhënies së tij.

Duhet punuar me rigorizitet dita-ditës në fuqizimin e sektorit të edukimit dhe të mësimit dhe në zgjerimin e mundësive të tij në dy drejtime: zgjerimin e kulturës dhe zgjerimin e njohurive të bijve të popullit, me qëllim që besimi i tyre të jetë sa më i pastër dhe i begatë.

Ju jeni ata që sot edukoni dhe përgatitni brezat e ardhshëm dhe ata që do të marrin në dorë çështjet e këtij vendi.

Ju duhet t'i kushtoni vëmendje të madhe edukimit rrënjësor dhe të vazhdueshëm.

Në realitet, mësuesit janë ata që përgatisin lëndën e pastër në botën e krijimit, prania e së cilës konsiderohet e domosdoshme për përparimin dhe civilizimin e njeriut, si nga ana materiale, ashtu edhe shpirtërore.

Mësuesit janë formuesit e njeriut të lartë dhe model, formuesit e njeriut që gëzon fatin e edukimit dhe të mësimit.

Sektori i edukimit dhe i mësimit konsiderohet prej sektorëve të shquar, prandaj falënderojeni Allahun, i Cili u ka mirësuar me këtë përgjegjësi. Lutjuni Atij që t'ju mbarësojë në kryerjen e këtij misioni ashtu siç e meriton.

Kur zbatoni edukimin e brezit të ri, dini se në realitet, ju po edukoni fuqitë njerëzore në vend.

Duhet që mësimi të jetë i tillë që të formojë mendjen, të aktivizojë logjikën dhe të krijojë mall për mësimin në zemrën e nxënësit të dijes.

Dija, në vetvete, nuk është e mjaftueshme, por duhet që ajo të jetë e shoqëruar me edukimin.

Unë besoj se mësuesi i fizikës, i gjeografisë a i matematikës mund të ndikojë aq shumë në mentalitetin e nxënësit nëpërmjet fjalës së mirë dhe edukatës së tij, sa që një libër i plotë nuk mund ta ketë këtë ndikim.

E drejta dhe e padrejta



Kur atmosfera që jeton vendi është atmosferë e drejtë dhe e drejta është ajo që sundon, atëherë edhe njerëzit do të jenë me të drejtën dhe zemrat e tyre do të anojnë nga ajo.

Ajo, së cilës i duhet vënë theksi, është qartësimi i së drejtës nga e padrejta.

E drejta që e besojmë për të gjithë popujt janë ato perceptime, të cilat, njerëzit i duan dhe i pranojnë.

Është e drejta e të gjithëve që të ndiejnë se realizimi i drejtësisë dhe refuzimi i padrejtësisë kryhet pa asnjë favorizim.

Unë ju ftoj që të jeni besimtarë në premtimin e Allahut, i Cili u ka premtuar të drejtëve se po të kapen pas të drejtës së tyre, pa dyshim që triumfi do të jetë aleati i tyre.

E drejta është vendi i vërtetë dhe në përputhje me urtësinë e Allahut. Ajo duhet të ndiqet dhe në vijën e saj.

Duhet që procesit të realizimit të së drejtës t'i kushtohet rëndësi më shumë se sa bisedës rreth saj.

Ligjet tona janë ato të Allahut. Çdo keqbërje, padrejtësi dhe kundërshtim apo nënvleftësim që i bëhet ligjit në zbatimin e detyrës, konsiderohet si kundërshtim i së drejtës.

Flamuri i së drejtës nuk qëndron në një rresht me të padrejtën dhe nuk e pranon kontekstin e saj. Kjo është ajo që ka thënë qartë imam Hysejini (paqja qoftë mbi të!): "*E largët është prej nesh poshtërsia.*"

Ata që duan të formojnë gjeografinë e tokës sipas dëshirave dhe qejfeve të okupatorëve, nuk mund të jenë në pajtim me të drejtën, sepse e drejta nuk e pranon këtë veprim të padrejtë të tyre.

Flijimi në rrugën e Allahut e lëkund fronin e të padrejtëve. Ai garanton vazhdimësinë e rrugëtimit për zhdukjen e së padrejtës dhe të vendosjes së drejtësisë në shoqërinë islame.

Prindërit



Vërtet, disa prindër janë mësues, ndoshta edhe më të mirë se mësuesit.

Vërtet, mbikëqyrja më e mirë është mbikëqyrja e popullit dhe ajo e prindërve.

Duhet që nënat dhe baballarët t'i udhëzojnë fëmijët e tyre në thënie dhe në punë të mira dhe në namaz.

Çdo i ri ka nevojë për ndihmë mendore nga prindërit e tij. Askush të mos e mendojë se udhëzimet mendore, urdhërimi dhe ndalimi i prindërve për fëmijët e tyre janë vrasëse për shpirtin gjallërues të të rinjve.

Unë i porosis nënat dhe baballarët që t'u lënë vend fëmijëve të tyre për diskutime, dëshirë dhe respekt.

Ka shumë nëna, të cilat janë më superiore se baballarët nga ana mendore dhe perceptimi. Kjo, falë edukimit islam dhe falë trashëgimisë së pastër e të ndritur të Fatime Zahrasë (paqja qoftë mbi të!).

Dashuria e rrënjosur përcillet nëpërmjet edukimit të prindërve dhe edukatorëve...

Pavarësia



Sigurisht, sipas pikëpamjes së Islamit, ndërgjegjja njerëzore nuk ia lejon dhunën asnjë individi dhe asnjë shteti, që të anojnë kah ajo që duan dhunuesit, por lejon përballjen e tyre dhe mbrojtjen e nderit dhe të pavarësisë së njeriut.

Vërtet, Fuqitë e Mëdha janë armiq të çdo sistemi që dëshiron të qëndrojë mbi këmbët e veta dhe të jetë i pavarur.

Dijeni se asnjë popull nuk mund ta ruajë nderin, dinjitetin dhe pavarësinë e tij, veçse me qëndresë dhe sakrificë.

Ndoshta disa qeveri mund të dorëzohen për shkak të interesave personale të drejtuesve të tyre. Por, a mund të dorëzohet një qeveri dhe një popull që flasin në emër të Islamit dhe ftojnë në drejtësi e vërtetësi duke u kapur në pavarësinë dhe dinjitetin e tyre atdhetar?!

Padyshim që qëndrimet guximtare bazuar tek besimi dhe vigjilenca e lartë e të rinjve ftues tek e vërteta

dhe tek zbatimi i drejtësisë, janë rruga e drejtë për realizimin e lirisë dhe të pavarësisë.

Vërtet, Islami i realizon popujve lirinë dhe pavarësinë e tyre.

Ju porosis që të ruani shpirtin e krenarisë e të pavarësisë dhe të mbështeteni në fuqitë dhe mundësitë tuaja të brendshme.

Ju porosis që të jeni të vetëmjaftueshëm nga çdo gjë që ju zhvesh nga vlerat, krenaria, besimi, pavarësia, personaliteti dhe dinjiteti njerëzor...

Zgjedhja jonë është rezistenca në qëndrimet që burojnë tek krenaria jonë, tek Islami ynë dhe tek vlerat tona islame e atdhetare, me qëllim që të huajt ta ndiejnë se me këtë popull nuk mund të bashkëpunosh me metoda kryeneçe dhe arrogante.

Liria



Ne jemi të parët që kemi ngritur parullat e lirisë, ku përmendet liria e mediave dhe e mendimeve. Falënderojmë Allahun që akoma vazhdojmë po me atë qëndrim. Ne kundërshtojmë lirinë e mëkateve dhe liritë shkatërruese.

Duhet që të mos e ushqejmë mendjen e të rinjve me ato që e çojnë në mëkate e shkatërrim, sepse kjo bie ndesh me dhënien e lirisë së mendjes për të zgjedhur rreth një çështjeje.

Është e natyrshme që ne i kundërshtojmë disa liri. A dyshon kush që ne refuzojmë lirinë e marrëdhënieve seksuale të jashtëligjshme dhe lirinë e bërjes së gjynaheve?!

Mos iu frikësoni zhurmës dhe as propagandës, të cilat ju akuzojnë se jeni kundër lirisë.

Sikur t'i keni liritë më të gjera dhe të mbronni parimet tuaja, gjithashtu do t'ju akuzojnë se jeni kundër lirisë.

Liria islame përmban lirinë shoqërore, individuale dhe shpirtërore. Ajo ka kriteret e saj, perceptimet e saj, udhëzimin e saj dhe kuptimin e saj islam.

Feja është ajo që i jep liri dhe nder njeriut. Ajo i jep njeriut dinjitet dhe personalitet.

Mos i lejoni disa prej të shthururve, që në emër të lirisë, të përhapin të ndaluarat, të këqijat dhe shpërbërjen e shoqërisë.

Në realitet, është për të qarë për lirinë, për shkak të keqpërdorimit të emrit të saj.

Unë them se duhet të përhapen në formë të rregullt mendimet, opinionet dhe preferencat e ndryshme...

Vërtet, liria është dhuratë e Allahut për popujt. Liria është e drejta e popullit dhe pjesë e natyrës së tij.

Motoja bazë e revolucionit përbëhej nga tri fjalë: pavarësia, liria dhe Republika islame.

Po të mos ishte pavarësia, populli nuk do të arrinte realizimin e lirisë së tij dhe as nuk do ta shihte me syrin e shpresës moton (parullën) e lirisë së tij.

Libri



Duhet që libri të jetë i mirë që të jetë i vazhdueshëm dhe të marrë vendin e tij në zemra. Qëllimi me **libër të mirë** është për atë që vjen si përgjigje për pyetjet dhe për një nevojë të caktuar.

Vërtet, në të shkuarën janë botuar shumë libra, por nuk dimë asgjë nga ato dhe nuk gjendet në duart e njerëzve asgjë prej tyre. Të tillë libra duhen ringjallur.

Cilësia e librit është kur i përgjigjet nevojave të caktuara. Kjo është e rëndësishme që të merret në konsideratë përsa i përket çështjes së librit.

Vërtet, libri është prej produkteve më të çmuara të njeriut. Ai është thesar, i cili përfshin pasurinë më madhështore të njerëzimit që është dija dhe hulumtimi.

Feja e njeriut, jeta e tij, trupi i tij dhe shpirti i tij ushqehen falë mirësive të librit dhe me anë të librit realizohet rrugëtimi i përsosurisë së njeriut.

Libri është babai i qytetërimeve dhe konkluzioni i tyre.

Njerëzit grumbullojnë shumë prej mësimëve që ua mëson atyre Libri i Krijimit. Ata i shkruajnë mësimet në libra dhe i përhapin në mesin e njerëzve.

Përhapja e librit nëpër bibliotekat e vendit është një detyrë shumë e rëndësishme dhe shpresojmë që të zbatohet më shumë se më parë.

Vërtet, libri përfaqëson portën drejt botës së njohjes dhe të dijes. Libri i mirë përfaqëson një prej mjeteve më të përkryera për përsosurinë e njeriut.

Ai njeri që nuk është i lidhur me botën e bukur të librit, të mbushur me vitalitet e gjallëri, padyshim që është privuar nga arritjet më të mëdha njerëzore dhe nga njohuritë më madhështore të Zotit.

Është një humbje e madhe për atë popull, bijtë e të cilit nuk shoqërohen me librin. Vërtet, është fitore e madhe për atë popull, bijtë e të cilit shoqërohen vazhdimisht me librin dhe përfitojnë prej tij.

Është e domosdoshme përhapja e librit për hir të kulturës së përgjithshme.

Shpirti i dijes



Vërtet, Islami e udhëzon njerëzimin për të dalë nga errësirat. Njerëzimi udhëzohet në këtë rrugë nëpërmjet rrugës së dijes, veprimit, vendosmërisë dhe mendimit të shëndoshë e të saktë.

Duhet që mësimi të jetë në atë formë që të ndërtojë mendjen, të forcojë inteligjencën dhe të krijojë nxitje për dijen në zemrat e nxënësve, e cila është më parësore.

Duhet që në zemrat e nxënësve të dijes të krijohet ndjenja e mallit dhe e dëshirës, si për dijet e përgjithshme, ashtu edhe për degët e posaçme shkencore.

Shikojeni brezin e sotëm, i cili është zbukuruar me dijet dhe njohjet e kohës. Edhe pse i mbartin këto dije, ata nuk e kanë harruar Islamin, siç mund ta hamendësojnë kolonizatorët, por ata janë të drejtuar kah Islami me besim të fuqishëm.

Nuk duhet që njeriu ta kërkojë dijen me qëllim që të mburret para të tjerëve apo të krekoset në mesin e njerëzve.

Unë besoj plotësisht se duhet përfituar prej eksperimenteve shkencore që ka bërë njerëzimi dhe nuk duhet mbyllur kurrë kjo dritare, por duhet të zgjedhim më të mirat shpikje dhe zbulime të të tjerëve.

Pasqyra e lëndës

Biografia e Sejjid Ali Khamenei.....	5
Teuhidi.....	20
Mesazhi islam.....	23
Kur'ani.....	25
Profeti Muhamed.....	29
Namazi.....	33
Zekati dhe sadakaja.....	38
Haxhi dhe dimensionet e tij.....	39
Agjërimi dhe muaji i Ramazanit.....	43
Ringjallja dhe Kiameti.....	46
Adhurimi.....	48
Uniteti.....	50
Urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja.....	54
Fetë.....	58
Predikimi.....	61
Thirrja.....	63
Ymeti islam.....	65
Shoqëria islame.....	66
Të drejtat e njeriut.....	68
Familja islame.....	70
Edukimi.....	71
E drejta dhe e padrejta.....	75
Prindërit.....	77
Pavarësia.....	78
Liria.....	80
Libri.....	82
Shpirti i dijes.....	84

نام کتاب: منتخب کلمات قصار

از

سید علی خامنه ای

تیرانا: 2014

نام کتاب: منتخب کلمات قصار از سید علی خامنه ای

مترجم: ولنت مریا

ویرایش: لیسدا رامای

مقابله: ویولسا کارای

صفحه بندی و جلد: صبریه فزا

ناشر: جمعیه النسیم

تیرانا: 2014